



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2538, datë 19.02.2015

Për

Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.02.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-201, dhe Njoftimin për tender publik.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Neni 69 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008, “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie të drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar Kreu III, Zhvillimi i procedurave, pika 1.3;

4. Dokumentit - Nr.339 Prot., datë 22.01.2015, (Pro.t i AKEP: 1956/9, datë 26.01.2015) të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Përgjigje tuajes Nr. 1956/8 Prot., datë 23.12.2014 "Dërgohet propozim për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre ".
5. Urdhërin Nr. 1393, datë 27.01.2015 "Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave".
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Dokumentat e hartuar nga njësia e hartimit të dokumentave së bashku me relacionin përkatës
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

Dokumentacioni për **Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS", Ref. 14-2x5-10x5-201, dhe Njoftimin për tender publik** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Duke marrë në konsideratë:

- Dokumentin e Tenderit;
- Njoftimin për tender publik;
- Shkresën Nr.339 Prot., datë 22.01.2015, (Pro.t i AKEP: 1956/9, datë 26.01.2015) të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Përgjigje tuajes Nr.1956/8 Prot., datë 23.12.2014 "Dërgohet propozim për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre ".
- Urdhërin Nr. 1393, datë 27.01.2015 "Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave".

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin e Tenderit publik me “Procedurë të hapur” me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”*, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Njoftimin për Tender, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Njoftimi për tender të botohet njëherë në një gazetë ndërkombëtare dhe dy herë në gazetë kombëtare.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

FTESE PER OFERTE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ketu e me poshte AKEP) si organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike ne Republikën e Shqipërisë, të përcaktuar nga Ligji Nr. 9918, date 19.5.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ne perputhje me parashikimet e nenit 69 te ketij ligji dhe me vendimin e Keshillit te Ministrave, VKM Nr. 1252, date 10.9.2008, “Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave”, i ndryshuar, hap tenderin:

Procedura e prokurimit: *Procedure e hapur*

Objekti: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.*

I- BREZAT E FREKUENCAVE

Procedura e tenderit zhvillohet per te dhene 14 (katermbedhjete) + 10 (dhjete) Autorizime ne brezat e frekuencave sipas tabelës se meposhtme (Tab.1) per perdorim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Shfrytezimi i spektrit do te behet ne perputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, ku ky brez është përcaktuar si perdorim kryesor për TRA-ECS. IMT është konsideruar si pjesë e TRA-ECS. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e “Electronic Communications Committee”- ECC/DEC/(02)06 dhe ECC/DEC/ (05)05, me Vendimin e Komisionit te 13 Qershorit 2008 “On the harmonisation of the 2500-2690 MHz frequency band for terrestrial systems capable of providing electronic communications services in the Community” me Rekomandimin e Komitetit ECC/REC (11)05 “Frequency planning and frequency coordination for terrestrial systems for mobile/fixed communication networks (MFCN) capable of providing Electronic Communications Services in the frequency band 2500-2690 MHz, rekomandimin ERC/REC (01)01 dhe standartin EN 301 908 dhe EN 302 544.

Tab.1

- a) 14 blloqe, te drejta perdorimi, 2x5 MHz (i çiftuar) dhe
- b) 10 blloqe, te drejta perdorimi, 5 MHz (i paçiftuar)

E drejta e perdorimit	Frekuenca per te drejte perdorimi	Madhesia e bllokut
A1	2500-2505/2620-2625 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A2	2505-2510/2625-2630 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A3	2510-2515/2630-2635 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A4	2515-2520/2635-2640 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A5	2520-2525/2640-2645 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A6	2525-2530/2645-2650 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A7	2530-2535/2650-2655 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A8	2535-2540/2655-2660 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A9	2540-2545/2660-2665 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A10	2545-2550/2665-2670 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A11	2550-2555/2670-2675 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A12	2555-2560/2675-2680 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A13	2560-2565/2680-2685 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A14	2565-2570/2685-2690 MHz (FDD)	2 x 5 MHz

E drejta e perdorimit	Frekuenca per te drejte perdorimi	Madhesia e bllokut
B1	2570-2575 MHz (TDD)	5 MHz
B2	2575-2580 MHz (TDD)	5 MHz
B3	2580-2585 MHz (TDD)	5 MHz
B4	2585-2590 MHz (TDD)	5 MHz
B5	2590-2595 MHz (TDD)	5 MHz
B6	2595-2600 MHz (TDD)	5 MHz
B7	2600-2605 MHz (TDD)	5 MHz
B8	2605-2610 MHz (TDD)	5 MHz
B9	2610-2615 MHz (TDD)	5 MHz
B10	2615-2620 MHz (TDD)	5 MHz

NDARJA NE BLOQE NE BREZIN 2500-2690 MHZ

Biloqet FDD Uplink														TDD										Biloqet FDD Downlink													
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	10'	2'	3'	4'	5'	6'	7'	8'	9'	10'	11'	12'	13'	14'
2500	2505	2510	2515	2520	2525	2530	2535	2540	2545	2550	2555	2560	2565	2570	2575	2580	2585	2590	2595	2600	2605	2610	2615	2620	2625	2630	2635	2640	2645	2650	2655	2660	2665	2670	2675	2680	2685

Spektri i ciftuar biloqet 1-14 FDD Uplink me biloqet 1'-14' FDD downlink

Spektri i paciftuar biloqet 1-10 TDD

II- QELLIMI

Te drejtat e perdorimit jepen me qellim ndertimin e rrjeteve tokesore te komunikimeve elektronike per te ofruar shërbime te komunikimeve elektronike ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

III- PJESEMARRJA NE TENDER

1.1.Kandidatet ose ofertuesit, per te marre pjese ne proceduren e tenderit per te fituar te drejten per marrjen e Autorizimit Individual duhet te paraqesin :

- a. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk eshte ne proces falimentimi, leshuar nga autoriteti kompetent.
- b. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk eshte denuar per shkelje penale, leshuar nga autoriteti kompetent.
- c. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) eshte i padenuar me vendim te gjykates se formes se prere, per kryerje te njeres nga veprat:
 - Pjesemarrje ne organizata kriminale;
 - Korrupsion;
 - Mashtrim;
 - Pastrim parash.
 leshuar nga autoriteti kompetent.
- d. Nje dokument qe verteton se kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk jane ne duart e permbaruesit gjyqsor apo ekziston nje urdher sekuestroje per to, leshuar nga autoriteti kompetent (Zyra e Permbarimit per ofertuesit vendas).
- e. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) i ka plotesuar detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore leshuar nga autoriteti kompetent (Administrata Tatimore per ofertuesit vendas).

- f. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk ka borxhe apo detyrime te tjera te pashlyera ndaj Shtetit Shqiptar (me vetdeklarim).
- 1.2. Ofertuesi duhet te jete i regjistruar ne regjistrat perkates profesionale ose tregtare te shtetit ne te cilin ata jane themeluar, duke vertetuar personalitetin e tyre ligjor si shoqeri aksionere ose person juridik. Per kete ato kandidat duhet te dorezojne nje kopje te Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit te leshuar nga autoriteti kompetent (Qendra Kombetare e Regjistrimit per ofertuesit vendas).
- 1.3. Te gjitha kerkesat e pikes 1.1 dhe 1.2 me siper, duhet te vertetohen nepermjet certifikatave zyrtare nga autoritetet perkatese ose me ane te dokumenteve te tjera zyrtare, te leshuara jo me heret se 30 dite kalendarike perpara dates njoftimit te AKEP per zhvillimin e tenderit. Dokumentat per te cilet nuk ka ligjerisht nje organ kompetent per leshimin e tyre, do te pranohen vetedeklarimet me shkrim nga ofertuesi. Nese dokumentet e siperpermendura, per kandidatet ose ofertuesit e huaj, nuk leshohen ne shtetin e tyre te origjines, atehere mjafton nje deklarate me shkrim nga kandidati ose ofertuesi.
- 1.4. Te gjitha dokumentat e paraqitura sipas kerkesave te pikave 1.1 dhe 1.2 me siper, duhet te jene dokumenta origjinale ose fotokopje te noterizuara. Dokumentat ne gjuhe te huaj (te ndryshme nga gjuha anglisht) duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe ose anglisht.
- 1.5. Oferte mund te paraqitet edhe nga bashkime investitoresh qe veprojne se bashku per qellime te pjesemarrjes ne tender dhe qe synojne te kryejne transaksionin nepermjet nje shoqerie qe do te krijohet. Ne keto raste, njeri prej investitoreve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate procedurave pas shpalljes se rezultateve te tenderit.
- 1.6. Vleresimi do te jete i pershkallezuar, me disa raunde vleresimi.
- Numri maksimal i raundeve te vleresimit eshte 4 (kater)
 - Te gjitha ofertuesit, si dhe ortaket e tyre te cdo lloji, mund te paraqesin vetem nje oferte me shenimin:
 - Oferte per pjesemarrje ne tenderin me objekt: ***“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.***
- Brenda ketij zarfi duhet te futen te gjitha ofertat, per cdo raund vleresimi, te ndara ne zarfa te vecante dhe te shenuar:
- “Oferte per marrjen e “x” (ku x merr vlerat 1 ose 2) te drejta perdorimi ***ne brezin e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, e vlefshme per raundin e “y” te vleresimit (ku y merr vlerat 1- 4 te raundeve te vleresimit perkatese).***
 - a) Nje ofertues nuk mund te ofertoje per me shume se 2 (dy) te drejta perdorimi nga grupi A dhe po kaq nga grupi B ne nje raund vleresimi.
 - b) Nje ofertues nuk mund te marre me shume se 4 (kater) te drejta perdorimi ne total nga grupi A dhe po kaq nga grupi B ne perfundim te vleresimit.
- 1.7. Per plotesimin e kerkesave ofertuesit duhet ti referohen Dokumentit te Tenderit Kreu II, Seksion 1.
- 1.8. Mosplotesimi i njerit prej ketyre kushteve perben shkak per skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.

2.Kërkesa të përgjithshme për kualifikim

2.1 Ofertuesit duhet të paraqesin në ofertën e tyre dokumentat që vërtetojnë se plotësojnë kërkesat e përgjithshme për kualifikim, si më poshtë:

a) *kualifikimi profesional*

- Ofertuesi duhet të vërtetojë se zoteron njohuri profesionale dhe eksperiencë mbi shfrytëzimin e frekuencave e teknologjive që operojnë në brezat ose GSM dhe/ose UMTS dhe/ose BWA, sipas përcaktimeve të **Shtojcës 4**.
- Në rastet e bashkimit të investitoreve, ky kusht duhet të përmbushet nga i gjithë grupi i marrë se bashku.

b) *afësitë teknike*

- Ofertuesi duhet të paraqesë planin dhe diagramat për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit që do të ndërtohet në vite. Ofertuesi gjithashtu duhet të plotësojë **Shtojcën 5**. Në rast se deklarimi i ofertuesit në tabelën e shtojcës 5, është me i vogël se vlerat minimale të dhëna në kolonën “Minimumi” të kesaj table, ofertuesi nuk kualifikohet,
- Ofertuesi duhet të garantojë shfrytëzimin e frekuencave në përputhje me rekomandimet dhe standardet e ITU, CEPT si dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është pale sipas deklaramit në **Shtojcën 7**.

c) *gjendja ekonomike e financiare*

Ofertuesi duhet të vërtetojë se zoteron kapacitete ekonomike e financiare për të përmbushur detyrimet e Autorizimit Individual, me anë të :

- I. deklaratave bankare të leshuar nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare të ofertuesit, të cilat garantojnë përmbushjen nga ana e ofertuesit të detyrimeve që rrjedhin nga marrja e Autorizimit Individual sipas deklaramëve të Shtojcës 5, 6, 7 dhe 8, por jo më pak se 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Euro. Në rast të mos-realizimit të këtij kushti, ofertuesi nuk kualifikohet.
- II. pasqyrave financiare (bilance, pasqyra të ardhura shpenzime) ose pjesë të shkeputura nga keto pasqyra financiare të njerit nga tre vitet e fundit financiare. Përfshihen nga ky detyrim ofertuesit që kanë filluar ushtrimin e aktivitetit në vitin financiar në vijim.
- III. një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë të realizuar nga veprimtaritë e ngjashme të njerit nga tre vitet e fundit financiar. Përfshihen nga ky detyrim ofertuesit që kanë filluar ushtrimin e aktivitetit në vitin financiar në vijim.

d) *kapacitetet ligjore*

Ofertuesi duhet të vërtetojë se ka zotesinë juridike për të përmbushur detyrimet e Autorizimit Individual, nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së regjistrimit si subjekt tregtar leshuar nga autoriteti kompetent (Qendra Kombëtare e Regjistrimit për ofertuesit vendas).

Në rastet e bashkimit të shoqërive kjo kërkesë do të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së regjistrimit si subjekt tregtar leshuar nga autoriteti kompetent

(Qendra Kombetare e Regjistrimit per ofertuesit vendas) nga te gjithë anetaret e grupit, si edhe marreveshjes se noterizuar te bashkimit te tyre.

- 2.2 I gjithë dokumentacioni ne permbushje te pikave 2.1.c dhe 2.1.d me siper, duhet te jete origjinal ose kopje legale ne perputhje me legjislacionin ne vendin e origjines. I gjithë dokumentacioni ne permbushje te pikave 2.1.a, dhe 2.1.b me siper dhe 4.4 ne seksionin 4, duhet te jete i vulosur dhe i nenshkruar nga personi i autorizuar nga ofertuesi.
- 2.3 Ne rastet e bashkimit te investitoreve, kerkesat e percaktuara ne piken 2.1, duhet te permbushen nga i gjithë grupi i marre se bashku, pervec rasteve te cituara ndryshe ne paragrafin e fundit ne piken 2.1.d.
- 2.4 Mos plotesimi i njerit prej ketyre kushteve perben shkak per skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.

IV- PARAQITJA E OFERTAVE

1. Paraqitja e ofertave behet si me poshte:
 - a) ofertat dorezohen me shkrim, dorazi ose permes postes, te nenshkruara dhe te mbyllura ne zarf, sipas percaktimeve te ketij dokumenti tenderi;
 - b) AKEP, sipas kerkeses, pajis ofertuesit me nje deshmi, ku shenohen data dhe ora e pranimit te ofertes.
2. Oferta dhe te gjithë dokumentat e korrespondenca qe lidhet me oferten, e shkemberyer ndermjet Ofertuesit dhe AKEP duhet te pergatiten ne gjuhen shqipe ose anglisht.
3. Ne rast te ofertave te paraqitura nga nje bashkim investitoresh, oferta duhet te shoqerohet me Prokuren/autorizimin me Shkrim per Personat e Autorizuar qe do te perfaqesojne bashkimin gjate procedures se tenderit.
4. Ofertuesit duhet te dorezojne oferten te futur ne nje zarf jotransparent, te mbyllur, te vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresen e Ofertuesit me shenimin:
 - Oferte per pjesemarrje ne tenderin me objekt: ***“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.***Brenda ketij zarfi duhet te futen te gjithë ofertat, per cdo raund vleresimi, te ndara ne zarfa te vecante dhe te shenuar:
 - ***“Oferte per marrjen e “x” (ku x merr vlerat 1 ose 2) te drejta perdorimi ne brezin e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, e vlefshme per raundin e “y” te vleresimit (ku y merr vlerat 1- 4 te raundeve te vleresimit perkatese).***

Siper zarfit te ofertes te shenohet: “TE HAPET VETEM KUR ESHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLËRESIMIT TE OFERTES, DHE JO PARA DATES 09.04.2015, ora : 10:00 ”.

V. AFATI DHE ADRESA E DOREZIMIT TE OFERTAVE

Ofertat duhet te dorezohen jo me vonë se data **09.04.2015, ora 10:00**, ne adresen :

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Rruga “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX,
Tirane – Shqiperi

VI. HAPJA E OFERTAVE

1. Ofertat do te hapen nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave (KVO), me data **09.04.2015, ora 10:00**, ne ambientet e AKEP ne adresen :

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Rruga “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX,
Tirane – Shqiperi

2. Ofertuesit ose perfaqesuesit e tyre te autorizuar te pajisur me autorizim, qe kane paraqitur oferta, kane te drejte te marrin pjese ne hapjen e ofertave.
3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e te cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kerkuar nga AKEP, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me ze te larte per ata persona qe jane te pranishem dhe regjistroheshen ne procesverbalin e procedures se tenderit.

VII. KRITERET E VLERESIMIT TE OFERTAVE

Kriteri i vleresimit te ofertave eshte :

- Çmimi i ofertes

Piket kriter

Nr	Kriteri i vleresimit	Piket
1	Çmimi i ofertes	0 ÷ 100

Cmimi i ofertes 0÷100 pike

Do te vleresohet me 100 pike oferta qe do te paraqese cmimin me te madh.

Per me shume detaje per kriteret e vleresimit dhe perlllogaritjen e pikeve per cdo oferte ofertuesit duhet ti referohen Dokumentit te Tenderit, Kreu II, seksion 12.

VIII. CMIMI MINIMAL I OFERTES

- a) Çmimi minimal i pranueshëm për ofertuesit për te drejte perdorimi 2x5 MHz per grupin A do te jete 750.000 (shtateqind e pesedhjetë mijë) Euro dhe per te drejte perdorimi nga grupi B do te jete 60.000 (gjashtedhjetë mijë) Euro.
- b) Ofertuesit të cilët kanë ofruar në ofertën e tyre një çmim më të vogël se keta vlera në kriterin “çmimi i ofertës” do të skualifikohen.

IX. DHENIA E AUTORIZIMIT NGA AKEP.

Dhenia e Autorizimit Individual do te behet brenda 10 diteve kalendarike pas shpalljes se fituesit dhe kryerjes te gjithë pagesave te referuara ne Seksionin 17 te Kreut II sipas percaktimeve te dokumentit te tenderit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. 9918, date 19.5.2008, i ndryshuar. Çmimi i ofertes, i ofruar nga ofertuesi qe ka fituar te drejten e perdorimit te frekuences/brezit te frekuencave te tenderuar, derdhet prej tij ne Buxhetin e Shtetit ne perputhje me percaktimet e njoftimit te AKEP per kete qellim. Kjo pagese do te kryhet nga ofertuesi fitues brenda 7 diteve kalendarike nga marrja e njoftimit te fituesit.

X. VLEFSHMERIA E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL

Autorizimi Individual do te jete i vlefshem per nje periudhe 15 (pesembedhjetë) vjecare, me mundesi rinovimi ne fund te perfundimit te periudhes se vlefshmerise. Rinovimi do te behet ne perputhje me percaktimet e Ligjit nr. 9918, date 19.5.2008, i ndryshuar, apo legjislacionit ne fuqi ne kohen perkatese.

XI. DETYRIMET E FITUESIT QE BUROJNE NGA TENDERI.

Fituesi/Operatori eshte i detyruar te filloje shfrytezimin e spektrit te alokuar nepermjet ketij tenderi brenda nje periudhe prej 2 (dy) muajsh nga data e marrjes se Autorizimit Individual.

Fituesi/Operatori me marrjen e Autorizimit Individual do te jete i detyruar qe te zbatoje, sipas deklarimive te dhena prej tij ne Oferte:

1. planin per shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit qe do ndertohet per mbulimin me sherbim;
2. ofrimin e te pakten sherbimeve te deklaruar;
3. standartet teknike te ITU dhe CEPT te deklaruar.

XII. DOKUMENTI I TENDERIT

Dokumentat e tenderit ne forme te printuar mund te terhiqen ne ambjentet e AKEP, gjate cdo dite pune duke filluar nga data 20.02.2015, nga ora 9:00 deri ne 15:30. Personi qe do te paraqitet per terheqjen e dokumentit te tenderit duhet te kete me vete dokumentin e bankes qe verteton kryerjen e pageses perkatese 10 (dhjete) euro.

Dokumenti i Tenderit mund te shkarkohet *pa pagese* nga faqja elektronike e AKEP, ne adresen www.akep.al.

Dokumenti i Tenderit eshte pergatitur ne gjuhen Shqipe dhe Anglisht.

XIII. PERSON KONTAKTI PER INFORMACIONE SHITESE

Per sqarime lidhur me dokumentin e tenderit mund te kontaktoni Z. Rudolf Papa, ne adresen:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Rruga “Abdi Toptani”,

Godina Torre Drini, K. IX,

Tirane – Shqiperi

Email: rudolf.papa@akep.al

Fax: +35542259106

“PROCEDURE E HAPUR”

Ref. 14-2x5-10x5-2015

OBJEKTI: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 2500-2690 MHZ PËR APLIKIMET TRA-ECS”

PERMBAJTJA E DOKUMENTIT TE TENDERIT

KREU I – TE PERGJITHSHME.....	13
1. Kuadri ligjor.....	13
2. Objekti i Tenderit.....	13
3. Pjesemarrja ne Tender.....	155
4. Dhenia e te drejtes se perdorimit (Dhenia e Autorizimit Individual)	15
5. Cmimi minimal i ofertes	15
6. Permbajtja dhe blerja e dokumentave te tenderit.....	166
KREU II – PROCEDURA E TENDERIT dhe UDHEZIME PER OFERTUESIT	167
1. Kerkesat e pjesemarrjes	177
2. Kerkesa te pergjithshme per kualifikim	18
3. Sqarimet dhe ndryshimi ne dokumentin e tenderit	20
4. Paraqitja dhe pranimi i ofertave	20
5. Skualifikimi i ofertave	22
6. Anullimi i tenderit.....	22
7. Sigurimi i ofertes.....	23
8. Vlefshmeria, modifikimi dhe terheqja e ofertave	23
9. Ndalimi i modifikimit te ofertave	24
10. Hapja e ofertave	24
11. Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave.....	24
12. Kriteret e percaktimit te ofertes fituese.....	255
13. Administrimi i informacionit ne proces.....	266
14. Njoftimi i fituesit dhe dhenia e autorizimit.....	27
15. Kushtet per zbatimin e autorizimit individual	277
16. Procedura e ankimit	27
17. Pagesat qe kryen fituesi	288
18. Gjeografia e perdorimit te frekuencave	29
19. Kushtet per perdorimin e frekuencave.....	29
20. Detyrimet e Fituesit qe burojne nga Tenderi.	29
21. Dhenia e Autorizimit nga AKEP.	300
22. Vlefshmeria e Autorizimit Individual.....	300
23. Interkoneksioni	300
24. Autorizimi i pergjithshem	300
25. Autorizimi Individual.....	311
26. Grafiku i zhvillimit te Tenderit.....	311
27. Veprimet e jashteligjshme.....	322
28. Zgjidhja e Mosmarveshjeve.....	322
KREU III - INFORMACION I PERGJITHSHEM	33
3.1 KUADRI LIGJOR	333
3.2 AUTORIZIMI PËR TË OFRUAR RRJETE DHE SHËRBIME TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM:.....	34
3.3 PANORAMA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE.....	35
3.4 TREGUES FINANCIARË TË SEKTORIT	37
3.5 TELEFONIA CELULARE.....	38
3.6 TE ARDHURAT E OPERATOREVE CELULAR.....	42

3.7 TELEFONIA FIKSE.....	44
3.8 INTERNETI.....	45
3.9 PLANI KOMBËTAR I FREKUENCAVE.....	47
4. SISTEMI I AUTORIZIMEVE.....	49
SHTOJCAT.....	500
SHTOJCA 1 FORMULARI I DOREZIMIT TE OFERTES.....	500
SHTOJCA 2 FORMULARI I DEKLARIMIT TE OFERTES.....	511
SHTOJCA 3 FORMULARI I ÇMIMIT TE OFERTES.....	522
SHTOJCA 4 – FORMULARI I AFTESIVE DHE EKSPERIENCES.....	533
SHTOJCA 5 – FORMULARI I PLANIT PER SHTRIRJEN DHE KONFIGURIMIN E RRJETIT QE DO NDERTOHEP PER MBULIMIN ME SHERBIM.....	544
SHTOJCA 6 – FORMULARI I DEKLARIMIT TE SHERBIMEVE.....	555
SHTOJCA 7 – FORMULARI I DEKLARIMIT PER STANDARDET.....	5656
SHTOJCA 8: DEKLARATE PER PRANIMIN E KUSHTEVE TE PERCAKTUARA NE NJOFTIMIN PER TENDER.	5757
SHTOJCA 9: DEKLARATE PER PRANIMIN E TE GJITHA DETYRIMEVE QE RRJEDHIN NGA FITIMI I TENDERIT.	5858
SHTOJCA 10: DEKLARATE PER PRANIMIN E TE GJITHA KUSHTET E DOKUMENTIT TE TENDERIT.....	5959
SHTOJCA 11 – FORMULARI I DEKLARATES PER PERSONIN E AUTORIZUAR DHE VERTESINE E TE DHENAVE.....	600
SHTOJCA 12 – FORMULARI I GARANCISE BANKARE PER SIGURIMIN E OFERTES.....	611
SHTOJCA 13 – FORMULARI I AUTORIZIMIT PER PERFAQESIM NE HAPJEN E OFERTAVE.....	622
SHTOJCA 14 FORMULARI I NJOFTIMIT TE SKUALIFIKIMIT.....	633
SHTOJCA 15 FORMULARI I NJOFTIMIT TE KLASIFIKIMIT.....	6666
SHTOJCA 16 FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT.....	6767
SHTOJCA 17 FORMULARI I BOTIMIT TE FITUESIT.....	6969
SHTOJCA 18 FORMULARI I AUTORIZIMIT INDIVIDUAL.....	700

KREU I – TE PERGJITHSHME

1. Kuadri ligjor

1.1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ketu e me poshte AKEP) me ane te Vendimit nr.xxxxx, date xx/02/2015 te Keshillit Drejtues, miratoi kete dokument te tenderit publik te bazuar ne “Proceduren e Hapur”, ***“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.***

1.2. “Procedura e Hapur” e Tenderit Publik (ketu e me poshte Tenderi) eshte hapur ne baze te:

- a) Ligjit Nr. 9918, date 19.5.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar.
- b) Vendimit Nr. 322, date 05.05.2010, te Keshillit te Ministrave “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë.
- c) Vendimit **466, datë 27.2.2013** “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave”.
- d) Vendimit Nr. 1252, date 10.9.2008, te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave” i ndryshuar.
- e) Dokumentit - Nr.339 Prot., datë 22.01.2015, (Pro.t i AKEP: 1956/9, datë 26.01.2015) të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Përgjigje tuajes Nr. 1956/8 Prot., datë 23.12.2014 "Dërgohet propozim për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre ”.

1.3. Dokumenti i tenderit percakton proceduren per pergatitjen, paraqitjen dhe vleresimin e ofertave. Asnje dokument tjeter nuk perben baze ligjore per tu aplikuar ne proceduren e ketij tenderi.

2. Objekti i Tenderit


- 2.1 Objekt i ketij Tenderi eshte : ***“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”***, sipas percaktimit te pikave 2.2 dhe 2.3 me poshte.
- 2.2 E drejta e perdorimit jepet me qellim ndertimin e rrjeteve tokesore te komunikimeve elektronike te per te ofruar shërbime te komunikimeve elektronike ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
- 2.3 Brezi i frekuencave qe do te jepet ne perdorim per cdo te drejte jepet ne tabelen e mepostme:

- a) 14 blloqe, te drejta perdorimi, 2x5 MHz (i çiftuar) dhe
 b) 10 blloqe, te drejta perdorimi, 5 MHz (i paçiftuar)

E drejta e perdorimit	Frekuenca per te drejte perdorimi	Madhesia e bllokut
A1	2500–2505/2620–2625 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A2	2505–2510/2625–2630 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A3	2510–2515/2630–2635 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A4	2515–2520/2635–2640 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A5	2520–2525/2640–2645 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A6	2525–2530/2645–2650 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A7	2530–2535/2650–2655 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A8	2535–2540/2655–2660 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A9	2540–2545/2660–2665 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A10	2545–2550/2665–2670 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A11	2550–2555/2670–2675 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A12	2555–2560/2675–2680 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A13	2560–2565/2680–2685 MHz (FDD)	2 x 5 MHz
A14	2565–2570/2685–2690 MHz (FDD)	2 x 5 MHz

E drejta e perdorimit	Frekuenca per te drejte perdorimi	Madhesia e bbllokut
B1	2570–2575 MHz (TDD)	5 MHz
B2	2575–2580 MHz (TDD)	5 MHz
B3	2580–2585 MHz (TDD)	5 MHz
B4	2585–2590 MHz (TDD)	5 MHz
B5	2590–2595 MHz (TDD)	5 MHz
B6	2595–2600 MHz (TDD)	5 MHz
B7	2600–2605 MHz (TDD)	5 MHz
B8	2605–2610 MHz (TDD)	5 MHz
B9	2610–2615 MHz (TDD)	5 MHz
B10	2615–2620 MHz (TDD)	5 MHz

NDARJA NE BLOQE NE BREZIN 2500-2690 MHZ



3. Pjesemarrja ne Tender

3.1 Te drejten per te marre pjese ne tender e kane te gjithë ato Kandidate ose Ofertues te cilet plotesojne kriteret dhe kerkesat e percaktuara ne kete Dokument Tenderi.

4. Dhenia e te drejtes se perdorimit (Dhenia e Autorizimit Individual)

4.1 Autorizimi Individual do tju jepet ofertuesve qe jane shpallur fitues pas perfundimit te procedures se Tenderit dhe nxjerrjes se njoftimit te fituesit nga AKEP.

4.2 AKEP do te kryej proceduren per dhenien e Autorizimit Individual ne perputhje me percaktimet e Ligjit Nr. 9918, date 19.5.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1252, date 10.9.2008, te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave”, i ndryshuar.

4.3 Pavec kushteve te Autorizimit Individual te cilat burojne nga kuadri ligjor dhe rregullator perkates, Autorizimi Individual do te permbaje kushte te tjera per perdorimin e frekuencave te percaktuara ne kete dokument tenderi. Keto kushte do te burojne nga deklarimet e ofertuesit ne oferten e tij, ne lidhje me sipermarrjen per permbushjen e kerkesave te Dokumentit te Tenderit.

5. Cmimi minimal i ofertes

5.1 Çmimi minimal i pranueshëm për ofertuesit për te drejte perdorimi 2x5 MHz per grupin A do te jete 750.000 (shtateqind e pesedhete mije) Euro dhe per te drejte perdorimi nga grupi B do te jete 60.000 (gjashtedhete mije) Euro.

5.2 Ofertuesit te cilet kane ofruar ne oferten e tyre nje cmim me te vogel se 750.000 (shtateqind e pesedhete mije) Euro për te drejte perdorimi 2x5 MHz per grupin A dhe me te vogel se 60.000 (gjashtedhete mije) Euro per te drejte perdorimi 5 MHz nga grupi B, ne kriterin “cmimi i ofertes”, do te skualifikohen.

6. Permbajtja dhe blerja e dokumentave te tenderit

- 6.1 Dokumentacioni i tenderit permban udhezime ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e ofertave per te fituar te drejten e marrjes te se drejtes se perdorimit te frekuencave te percaktuara ne kete dokument tenderi ne piken 2.3..
- 6.2 Dokumenti i Tenderit eshte pergatitur ne gjuhen Shqipe dhe Anglisht.
- 6.3 Cdo “subjekt” i interesuar, mund te bleje nje set te dokumentit te tenderit ne forme te printuar, nepermjet nje pagese prej 10 (dhjete) Euro, e cila do te derdhet ne llogarine bankare te AKEP, si me poshte:
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Llogaria Bankare: nr. 111113869030128
Banka : Union Bank
- 6.4 Kjo pagese eshte e parimbursueshme ne cdo lloj rrethane.
- 6.5 Dokumentat e tenderit ne forme te printuar mund te terhiqen ne ambjentet e AKEP, gjate cdo dite pune duke filluar nga data 20.02.2015, nga ora 9:00 deri ne 15:30. Personi qe do te paraqitet per terheqjen e dokumentit te tenderit duhet te kete me vete dokumentin e bankes qe verteton kryerjen e pageses sipas pikes 7.3. Dokumenti i Tenderit mund te shkarkohet *pa pagese* nga faqja elektronike e AKEP, ne adresen www.akep.al
- 6.6 AKEP do te beje rregjistrimin e cdo subjekti, i cili do te kryeje blerjen e dokumentit te tenderit.
- 6.7 AKEP nuk do te beje publik ne asnje rrethane, emrat e subjekteve qe kane blere dokumentat e tenderit.

KREU II – PROCEDURA E TENDERIT DHE UDHEZIME PER OFERTUESIT

1. Kerkesat e pjesemarrjes

1.1 Kandidatet ose ofertuesit, per te marre pjese ne proceduren e tenderit per te fituar te drejten per marrjen e Autorizimit Individual duhet te paraqesin :

- a. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk eshte ne proces falimentimi, leshuar nga autoriteti kompetent.
- b. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk eshte denuar per shkelje penale, leshuar nga autoriteti kompetent.
- c. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) eshte i padenuar me vendim te gjykates se formes se prere, per kryerje te njeres nga veprat:
 - Pjesemarrje ne organizata kriminale;
 - Korrupsion;
 - Mashtrim;
 - Pastrim parash.leshuar nga autoriteti kompetent
- d. Nje dokument qe verteton se kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk jane ne duart e permbaruesit gjyqsor apo ekziston nje urdher sekuestroje per to, leshuar nga autoriteti kompetent (Zyra e Permbarimit per ofertuesit vendas).
- e. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) i ka plotesuar detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore leshuar nga autoriteti kompetent (Administrata Tatimore per ofertuesit vendas).
- f. Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) nuk ka borxhe apo detyrime te tjera te pashlyera ndaj Shtetit Shqiptar (me vetdeklarim).

1.2 Ofertuesi duhet te jete i regjistruar ne regjistrat perkates profesionale ose tregtare te shtetit ne te cilin ata jane themeluar, duke vertetuar personalitetin e tyre ligjor si shoqeri aksionere ose person juridik. Per kete ato candidate duhet te dorezojne nje kopje te Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit te leshuar nga autoriteti kompetent (Qendra Kombetare e Regjistrimit per ofertuesit vendas).

1.3 Te gjitha kerkesat e pikes 1.1 dhe 1.2 me siper, duhet te vertetohen nepermjet certifikatave zyrtare nga autoritetet perkatese ose me ane te dokumenteve te tjera zyrtare, te leshuara jo me heret se 30 dite kalendarike perpara dates njoftimit te AKEP per zhvillimin e tenderit. Dokumentat per te cilet nuk ka ligjerisht nje organ kompetent per leshimin e tyre, do te pranohen vetedeklarimet me shkrim nga ofertuesi. Nese dokumentet e siperpermendura, per kandidatet ose ofertuesit e huaj, nuk leshohen ne shtetin e tyre te origjines, atehere mjafton nje deklarate me shkrim nga kandidati ose ofertuesi.

Te gjitha dokumentat e paraqitura sipas kerkesave te pikave 1.1 dhe 1.2 me siper, duhet te jene dokumenta origjinale ose fotokopje te noterizuara. Dokumentat ne gjuhe te huaj (te ndryshme nga gjuha anglisht) duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe ose anglisht.

- 1.4 AKEP, ne se do te jete e nevojshme te kerkohet informacion per kandidatin ose ofertuesin rezident ne nje shtet te huaj, do te kerkoje bashkepunimin e autoriteteve perkatese.
- 1.5 Mos plotesimi i njerit prej ketyre kushteve perben shkak per skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.
- 1.6 Oferte mund te paraqitet edhe nga bashkime investitoresh qe veprojne se bashku per qellime te pjese marrjes ne tender dhe qe synojne te kryejne transakcionin nepermjet nje shoqerie qe do te krijohet. Ne keto raste, njeri prej investitoreve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate procedurave pas shpalljes se rezultateve te tenderit.
- 1.7 Para dorezimit te ofertes, bashkimi i investitoreve duhet te krijohet zyrtarisht me ane te nje marreveshjeje te noterizuar, ne te cilen tregohet perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjese marrjes apo puna konkrete per secilin anetar, si dhe autorizimi/prokuren per perfaqesimin e anetareve te grupit, si per dorezimin e ofertes ashtu edhe per nenshkrimin e Autorizimit Individual ne rast te shpalljes fitues. Perfaqesuesi duhet te beje edhe sigurimin e ofertes, duke specifikuar pjese marrjen si bashkim i investitoreve. Marreveshja e noterizuar dhe prokura per perfaqesimin e anetareve te grupit duhet te perfishihet ne dokumentacionin e ofertes se dorezuar nga bashkimi i investitoreve.
- 1.8 Ne rastet e bashkimit te investitoreve, çdo anetar i grupit duhet te dorezoje vecmas dokumentat e lartpermendur. Nderkohe, kerkesat e tjera duhet te permbushen nga i gjithë grupi i marre se bashku.
- 1.9 Bashkimi i investitoreve nuk ndryshon pas dorezimit te ofertes, ne te kundert oferta e tij refuzohet.
- 1.10 Mosplotesimi i njerit prej ketyre kushteve perben shkak per skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.
- 1.11 Nje investitor (individual apo pjese e nje bashkimi) nuk mund te marri pjese ne me shume se nje oferte.
- 1.12 Vleresimi i ofertave do te jete i pershkallezuar, me disa raunde vleresimi.
- 1.13 Nje ofertues nuk mund te ofertoje per me shume se 2 (dy) te drejta perdorimi ne nje raund vleresimi.
Nje ofertues nuk mund te marre me shume se 4 (kater) te drejta perdorimi 2x5 MHz per grupin A dhe po kaq te drejta perdorimi 5 MHz nga grupi B, ne total, ne perfundim te vleresimit te ofertave per te gjitha raundet.

2 Kerkesa te pergjithshme per kualifikim

- 2.1 Ofertuesit duhet te paraqesin ne oferten e tyre dokumentat qe vertetojne se plotesojne kerkesat e pergjithshme per kualifikim, si me poshte:
 - a) *kualifikimi profesional*

- Ofertuesi duhet te vertetoje se zoteron njohuri profesionale dhe eksperience mbi shfrytezimin e frekuencave, dhe teknologjite qe operojne ne brezat ose GSM dhe/ose UMTS dhe/ose BWA, sipas percaktimeve te **Shtojces 4**.
- Ne rastet e bashkimit te investitoreve, ky kusht duhet te permbushet nga i gjithe grupi i marre se bashku.

b) *aftesite teknike*

- Ofertuesi duhet te paraqese planin dhe diagramat per shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit qe do te ndertohet ne vite. Ofertuesi gjithashtu duhet te plotesojë **Shtojcen 5**. Ne rast se deklarimi i ofertuesit ne tabelen e shtojces 5, eshte me i vogel se vlerat minimale te dhena ne kolonen “Minimumi” te kesaj tabele, ofertuesi nuk kualifikohet,
- Ofertuesi duhet te garantoje shfrytezimin e frekuencave ne perputhje me rekomandimet dhe standardet e ITU, CEPT si dhe marreveshjet nderkombetare ku Shqiperia eshte pale sipas, ne perputhje me deklarimin e **Shtojces 7**.

c) *gjendja ekonomike e financiare*

Ofertuesi duhet te vertetoje se zoteron kapacitete ekonomike e financiare per te permbushur detyrimet e Autorizimit Individual, me ane te :

- I. deklaratave bankare te leshuar nga nje ose me shume banka per gjendjen financiare te ofertuesit, te cilat garantojne permbushjen nga ana e ofertuesit te detyrimeve qe rrjedhin nga marrja e Autorizimit Individual sipas deklarimeve te Shtojca 5, 6, 7 dhe 8, por jo me pak se 750.000 (shtateqind e pesedhete mije) Euro. Ne rast te mos-realizimit te ketij kushti, ofertuesi nuk kualifikohet.
- II. pasqyrave financiare (bilanc, pasqyra te ardhura shpenzime) ose pjese te shkeputura nga keto pasqyra financiare te njerit nga tre vitet e fundit financiare. Perjashtohen nga ky detyrim ofertuesit qe kane filluar ushtrimin e aktivitetit ne vitin financiar ne vijim.
- III. nje deklarate te xhiros se pergjithshme te shoqerise te realizuar nga veprimtarite e ngjashme te njerit nga tre vitet e fundit financiar. Perjashtohen nga ky detyrim ofertuesit qe kane filluar ushtrimin e aktivitetit ne vitin financiar ne vijim.

d) *kapacitetet ligjore*

Ofertuesi duhet te vertetoje se ka zotesine juridike per te permbushur detyrimet e Autorizimit Individual, nepermjet paraqitjes se certifikate regjistrimit si subjekt tregtar leshuar nga autoriteti kompetent (Qendra Kombetare e Regjistrimit per ofertuesit vendas).

Ne rastet e bashkimit te shoqerive kjo kerkese do te vertetohet nepermjet paraqitjes te certifikates se regjistrimit si subjekt tregtar leshuar nga autoriteti kompetent (Qendra Kombetare e Regjistrimit per ofertuesit vendas) nga te gjithe anetaret e grupit, si edhe marreveshjes se noterizuar te bashkimit te tyre.

- 2.2 I gjithe dokumentacioni ne permbushje te pikave 2.1.c dhe 2.1.d me siper, duhet te jete origjinal ose kopje legale ne perputhje me legjislacionin ne vendin e origjines. I gjithe

dokumentacioni ne permbushje te pikave 2.1.a, dhe 2.1.b me siper dhe 4.4 ne seksion 4, duhet te jete i vulosur dhe i nenshkruar nga personi i autorizuar nga ofertuesi.

- 2.3 Ne rastet e bashkimit te investitoreve, kerkesat e percaktuara ne piken 2.1, duhet te permbushen nga i gjithe grupi i marre se bashku, pervec rasteve te cituara ndryshe ne paragrafin e fundit ne piken 2.1.d.
- 2.4 Mos plotesimi i njerit prej ketyre kushteve perben shkak per skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.

3 Sqarimet dhe ndryshimi ne dokumentin e tenderit

- 3.1 Ofertuesi i mundshem, mund te kerkoje sqarime nga AKEP, i cili do t'i pergjigjet çdo kerkese per sqarim te dokumentit te tenderit, te bere nga çdo sipermarres, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 5 dite kalendarike para afatit perfundimtar te dorezimit te ofertave. AKEP do te pergjigjet brenda 3 diteve kalendarike nga depozitimi i kerkeses, ne menyre qe te beje te mundur dorezimin e ofertes ne kohe nga sipermarresi dhe, pa identifikuar burimin e kerkeses, do t'i komunikojte kerkesen se bashku me sqarimin perkates te gjithe kandidateve te tjere, qe kane terhequr dokumentin e tenderit.
- 3.2 AKEP, ne çdo kohe, perpara mbarimit te afatit te fundit per dorezimin e ofertave te tenderit dhe per çfaredolloj arsyeje, me nismen e vet ose me kerkese per sqarim nga nje kandidat, mund te beje ndryshime ne dokumentin e tenderit, permes hartimit te nje shtojce. Çdo shtojce u komunikohet menjehere te gjithe kandidateve bleses, qe kane terhequr dokumentin e tenderit, dhe behet detyruese per ta. Shtojca vihet ne dispozicion edhe ne rruge elektronike. Ne çdo rast, AKEP e zgjat afatin kohor per dorezimin e ofertes me te pakten 5 dite kalendarike.
- 3.3 Format e kontaktit te AKEP me kandidatet, per sqarime per dokumentin e tenderit , do te jete nepermejt personit te kontaktit me ane te nje prej formave ne vijim: forme shkresore, fax, email.

4 Paraqitja dhe pranimi i ofertave

- 4.1 Ofertuesit i paraqesin ofertat e tyre ne perputhje me udhezimet dhe kushtet e percaktuara ne kete dokument tenderi, qe perfshin edhe plotesimin e te gjitha shtojcave perkatese te tij.
- 4.2 Ofertuesit paraqesin vetem nje oferte.
- 4.3 Oferta perfshin angazhimet e meposhtme:
 - a) pranimin, prej ofertuesit, te kushteve te percaktuara ne njoftimin per tender, sipas formatit te **Shtojces 8**;
 - b) pranimin, prej ofertuesit, te detyrimeve qe rrjedhin nga fitimi i tenderit, sipas formatit te **Shtojces 9**;
 - c) pranimin, prej ofertuesit, te kushteve te dokumentit te tenderit, sipas formatit te **Shtojces 10**;

- 4.4 Ofertuesi ne dokumentacionin e ofertes duhet te paraqese te plotesuar edhe dokumentat e meposhtem:
- Formularin e Dorezimit te Ofertes sipas formatit te percaktuar ne **Shtojcen 1**.
 - Formularin e Deklarimit te Ofertes sipas formatit te percaktuar ne **Shtojcen 2**.
 - Formularin e Çmimit te Ofertes sipas formatit te percaktuar ne **Shtojcen 3**.
- 4.5 Ofertat duhet te dorezohen jo me vone se data **09.04.2015, ora 10:00**, ne adresen :
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Rruga “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX,
Tirane – Shqiperi
- 4.6 Kur AKEP jep sqarime apo ben ndryshime ne dokumentin e tenderit, vepron ne perputhje me piken 3 me siper.
- 4.7 Vendimi per shtyrje te afatit perfundimtar u njoftohet menjehere te gjithë kandidatëve, qe kane terhequr dokumentet.
- 4.8 Paraqitja e ofertave behet si me poshte:
- c) ofertat dorezohen me shkrim, dorazi ose permes postes, te nenshkruara dhe te mbyllura ne zarf, sipas percaktimeve te ketij dokumenti tenderi;
 - d) AKEP, sipas kerkeses, pajis ofertuesit me nje deshmi, ku shenohen data dhe ora e pranimit te ofertes.
- 4.9 Ofertat e paraqitura pas mbarimit te afatit te fundit te paraqitjes se tyre u kthehen te pahapura ofertuesve qe i kane paraqitur ato.
- 4.10 Ofertuesi do te mbuloje vete te gjitha shpenzimet lidhur me pergatitjen dhe dorezimin e ofertes se tij.
- 4.11 AKEP nuk do te mbaje pergjegjesi per shpenzimet e kryera nga ofertuesi per pergatitjen dhe dorezimin e ofertes.
- 4.12 Oferta dhe te gjithë dokumentat e korrespondenca qe lidhet me oferten, e shkëmbyer ndermjet Ofertuesit dhe AKEP duhet te pergatiten ne gjuhen shqipe ose anglisht.
- 4.13 Oferta duhet te hartohet ne nje kopje origjinale, dhe duhet te shtypet ose te shkruhet me boje qe nuk fshihet. Te gjitha fletet e ofertes duhet te lidhen se bashku dhe te numerizohen. Te gjitha fletet e ofertes, pervec literatures se pandryshueshme e te printuar duhet te pajisen me iniciale ose te nenshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar nga Ofertuesi. Personi (at) i autorizuar per kete qellim do te identifkohen nepermjet nje dokumenti sipas formatit te **Shtojces 11**, i cili do te jete pjese e dokumentacionit te ofertes dhe duhet te jete i nenshkruar dhe i vulosur nga ofertuesi.
- 4.14 Ne rast te ofertave te paraqitura nga nje bashkim investitoresh, oferta duhet te shoqerohet me Prokuren/autorizimin me Shkrim per Personin e Autorizuar qe do te perfaqesojë bashkimin gjate procedures se prokurimit.
- 4.15 Ofertuesit duhet te dorezojne oferten te futur ne nje zarf jotrtransparent, te mbyllur, te vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresen e Ofertuesit me shenimin:

- Oferte per pjesemarrje ne tenderin me objekt: ***“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.***

Brenda ketij zarfi duhet te futen te gjithë ofertat, per cdo raund vleresimi, te ndara ne zarfa te vecante dhe te shenuar:

- ***“Oferte per marrjen e “x” (ku x merr vlerat 1 ose 2) te drejta perdorimi ne brezin e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, e vlefshme per raundin e “y” te vleresimit (ku y merr vlerat 1- 4 te raundeve te vleresimit perkatese).***

Siper zarfit te ofertes te shenohet: **“TE HAPET VETEM KUR ESHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLËRESIMIT TE OFERTES, DHE JO PARA DATES 09.04.2015, ora : 10:00 ”.**

5 Skualifikimi i ofertave

- 5.1 AKEP do te skualifikoje ne çdo kohe kandidatet ose ofertuesit, qe paraqesin te dhena te rreme ose nje dokument te falsifikuar, per qellime kualifikimi, gjate procedures se tenderit.
- 5.2 AKEP do te skualifikoje çdo kandidat apo ofertues, ndaj te cilit eshte marre vendimi i perjashtimit nga procedurat e prokurimit publik dhe ankandi, sipas legjislacionit perkates te RSH.
- 5.3 AKEP skualifikon çdo ofertues, oferta e te cilit eshte vleresuar me me pak se 60 pike.
- 5.4 Njoftimi i skualifikimit do te behet nga KVO nepermjet dergimit te njoftimit sipas Shtojca 15.

6 Anullimi i tenderit

- 6.1 AKEP, ka te drejte, ne çdo kohe, te anuloje tenderin, per arsye te interesit publik, duke respektuar parimet e barazise dhe te transparences. AKEP ne asnje rast nuk eshte i detyruar te shpalle fituesin e tenderit.
- 6.2 AKEP, nuk mban asnje pergjegjesi ndaj ofertuesve, qe kane paraqitur oferta, per vendimin e marre ne baze te pikes 6.1 me siper.
- 6.3 AKEP, ne perputhje me piken 6.1 te ketij kreu, u komunikon te gjithë kandidateve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet per te mos e vazhduar tenderin, brenda 5 diteve pune nga marrja e vendimit, dhe kete njoftim e publikon ne faqen e tij te internetit.
- 6.4 AKEP, ne perputhje me VKM nr.1252 ,date 10.09.2008 , i ndryshuar, anulon proceduren e tenderit ne rast se, ne perfundim te vleresimit te ofertave dhe perfundimit te procedures se anikimit nuk rezulton asnje oferte e vlefshme.

7 Sigurimi i ofertes

- 7.1 Kandidatet ose ofertuesit duhet te paraqesin sigurimin e ofertes, ne vleren 90,000 (nentedhjetemije) Euro, me ane te nje dokumenti sipas **Shtojca 12**.
- 7.2 Sigurimi i Ofertes do te jete i vlefshem per nje periudhe kohore prej 150 (njqind e pesedhjte) dite kalendarike nga data hapjes se ofertave te specifikuar ne kete dokument tenderi.
- 7.3 AKEP, nuk e pretendon vleren e sigurimit te ofertes dhe e kthen menjehere mbrapsht ate, nese:
- ka perfunduar afati kohor i sigurimit te ofertes;
 - jane anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.
 - fituesi eshte pajisur me autorizimin individual

8 Vlefshmeria, modifikimi dhe terheqja e ofertave

- 8.1 Nje oferte eshte e vlefshme nese:
- eshte marre nga AKEP, ne zyrat e tij ne Tirane, brenda dates 09.04.2015, ora : 10:00;
 - ofertuesi ploteson kerkesat e ketij dokumenti tenderi;
 - ofertuesi jep garancite e nevojshme;
 - ofertuesi nuk eshte skualifikuar sipas parashikimeve te ketij dokumenti tenderi.
- 8.2 Oferta do te jete e vlefshme per nje periudhe kohore prej 150 (njqind e pesedhjte) dite kalendarike nga data hapjes se ofertave te specifikuar ne kete dokument tenderi.
- 8.3 AKEP, perpara perfundimit te periudhes se vlefshmerise se ofertave, mund t'u kerkoje ofertuesve te zgjasin kete periudhe per nje afat te caktuar. Ne kete rast:
- ofertuesi mund te refuzoje kerkesen, pa humbur sigurimin e ofertes dhe vlefshmeria e ofertes se tij perfundon me mbarimin e periudhes fillestare te vlefshmerise;
 - kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhes se vlefshmerise, me te zgjatet edhe sigurimi i ofertes apo paraqitet nje sigurim i ri oferte, qe mbulon periudhen e zgjatur te vlefshmerise. Ofertuesi, qe nuk zgjat periudhen e sigurimit te ofertes, ose qe nuk paraqet nje sigurim te ri oferte, vleresohet se e ka refuzuar kerkesen per zgjatje te periudhes se vlefshmerise se ofertes.
- 8.4. Ofertuesit mund te modifikojne ofertat e tyre, vetem ne rast se AKEP ka bere ndryshim te dokumentit te tenderit te referuar ne seksion 3, Kreu II, te ketij dokumenti tenderi, dhe kur oferta eshte depozituar ne AKEP para dates se njoftimit te ndryshimit si edhe me kusht qe ky modifikim ose terheqje te kryhet para afatit kohor perfundimtar per paraqitjen e ofertave. Terheqjet duhet t'i komunikohen AKEP me shkrim para dates se fundit per dorezimin e ofertave. Kerkesa e Ofertuesit per terheqjen e ofertes duhet t'i dergohet AKEP e futur ne nje zarf jotransparent, te mbyllur, te vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresen e Ofertuesit dhe te shenuar: "TERHEQJE OFERTE".

9 Ndalimi i modifikimit te ofertave

- 9.1 Pas paraqitjes se ofertes nuk duhet te kryhet asnje bisedim per oferten ndermjet AKEP dhe ofertuesit, pa cenuar te drejten e parashikuar ne piken 11.2 me poshte.
- 9.2 AKEP nuk ka te drejte t'u kerkoje ofertuesve te ndermarrin pergjegjesi te papercaktuara ne dokumentin e tenderit, apo te ndryshojne vleren e ofertes ose ta modifikojne ne çfaredolloj menyre ate.

10 Hapja e ofertave

- 10.1 Ofertat do te hapen nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave (KVO), me date 09.04.2015, ne ora 10:00 , ne ambientet e AKEP ne adresen :

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Rruga “Abdi Toptani”,

Godina Torre Drini, K. IX,

Tirane – Shqiperi

- 10.2 Ofertuesit ose perfaqesuesit e tyre te autorizuar te pajisur me autorizim sipas **Shtojces 13**, qe kane paraqitur oferta, kane te drejte te marrin pjese ne hapjen e ofertave.
- 10.3 Emri, adresa e ofertuesit, oferta e te cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kerkuar nga AKEP, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me ze te larte per ata persona qe jane te pranishem dhe regjistrohene ne procesverbalin e procedures se tenderit.
- 10.4 Procesverbali do t'i vihet menjehere ne dispozicion, ne baze te kerkeses, çdo ofertuesi, ndersa ofertuesit qe ka paraqitur oferten, por qe nuk eshte i pranishem ose i perfaqesuar ne hapjen e ofertave, do t'i dergohet per njoftim.

11 Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave

- 11.1 Pas hapjes dhe leximit te ofertave te paraqitura, per raundin e pare te vleresimit, siç parashikohet me lart, KVO, nese gjykon se i nevojitet me shume se nje dite pune per te perfunduar veprimtarine e tij, ve ne dijene perfaqesuesit per oren dhe daten kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vleresimit te ofertave. Kohezgjatja e procedures nuk duhet te kaloje 30 dite kalendarike.
- 11.2 KVO, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime me shkrim per ofertat e tyre per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Nuk do te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne çmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme.
- 11.3 KVO, pavaresisht nga percaktimi i pikes 11.2 me siper, do te korrigoje vetem gabimet aritmetike, qe zbulohen gjate shqyrtimit te ofertave, me kusht qe keto te mos jene bere per qellime mashtrimi. AKEP njofton menjehere per keto korrigjime ofertuesin qe ka paraqitur oferten dhe propozimet jane te vlefshme nese pranohen nga ofertuesi.

- 11.4 KVO, vlereson se oferta eshte e vlefshme, nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e tenderit dhe ne dokumentin e tenderit.
- 11.5 KVO nuk e pranon nje oferte:
- a) kur ofertuesi nuk pranohet per shkaqe te percaktuara ne kete dokument tenderi;
 - b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e nje gabimi aritmetik, te bere sipas pikes 11.3 me siper;
 - c) kur oferta e tij nuk perputhet me specifikimet e percaktuara ne dokumentin e tenderit.
 - d) kur oferta nuk eshte shoqeruar me gjithë dokumentacion perkates te kerkuar ne kete dokument tenderi.
- 11.6 Vleresimi i ofertave kryhet mbi bazen e kriterëve te percaktuara ne kete dokument tenderi.
- 11.7 Vleresimi i ofertave do te jete i pershkallezuar, me disa raunde vleresimi.
- 11.8 Numri i maksimal i raundeve te vleresimit do te jete 4 (kater). Ky numer eshte subjekt i ndryshueshem (nga 1 deri ne 4) ne varesi te numrit te ofertave fituese per cdo raund.
- 11.9 Ne perfundim te procesit te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave, KVO, bazuar ne ofertat e pranuar, harton renditjen perfundimtare per cdo raund vleresimi, e cila duhet te njoftohet ne formen dhe ne kohen e percaktuar ne kete dokument tenderi, sipas **shtojca 16**.
- 11.10 Ne se dy ose me shume oferta kane pike te njejta, atehere fituesi do te percaktohet me short, ne prani te ofertuesve.
- 11.11 Ofertuesit, brenda 5 (pese) diteve pune, pas marrjes se njoftimit te klasifikimit te ofertave, kane te drejte te paraqesin ankim administrativ prane AKEP.
- 11.12 AKEP, pas shqyrtimit te ankesave, nese ka te tilla, i dergon nje njoftim ankimesit lidhur me vendimin e marre. Afati i shqyrtimit te ankesave eshte 5 (pese) dite pune nga marrja e saj.
- 11.13 KVO ne perfundim te afatit te ankimit administrativ prane AKEP, dorezon raportin permbledhes se tenderit. Ky raport do te hartohet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne VKM nr.1252, date 10.09.2008, i ndryshuar.

12 Kriteret e percaktimit te ofertes fituese

12.1 KVO vlereson dhe krahason ofertat ne baze te percaktimeve te meposhtme :

I. Kriteri i vleresimit te ofertave eshte :

- Çmimi i ofertes

Piket kriter

Nr	Kriteri i vleresimit	Piket
1	Çmimi i ofertes	0 ÷ 100

Cmimi i ofertes 0÷100 pike

Do te vleresohet me 100 pike oferta qe do te paraqese cmimin me te madh.

Perllogaritja e pikeve per cdo oferte do te behet si me poshte :

$$Pox(1) = 100 \times \frac{\text{Çox}}{\text{Çomax}}$$

Ku:

[Pox(1)] → [Piket e nje oferte te dhene (x) ne varesi te cmimit te ofertes]

[Çox] → [Çmimi i ofertes se dhene (x)]

[Çomax] → [Çmimi maksimal i ofertave]

Cmimi i ofertes per kete kriter do te deklarohet nga ofertuesi sipas Shtojca 3 Formulari i Cmimit te Ofertes.

Numri maksimal i pikeve qe mund te grumbullohen nga nje ofertues per cdo raund vleresimi eshte 100 pike. Renditja e ofertueseve ne cdo raund vleresimi do te behet ne rend zbrites duke filluar nga ofertuesi me numer me te larte pikesh, te llogaritura sipas formules (5).

- 12.2 AKEP, shpall fitues ne cdo raund vleresimi, ofertuesit me oferten e vlefshme qe kane grumbulluar numrin me te larte te pikeve sipas renditjes per ate raund. Numri i fituesve nuk e kalon numrin e te drejtave te perdorimit.
- 12.3 Ofertuesit te cilet kane grumbulluar me pak se **60 pike**, do te skualifikohen.
- 12.4 Ne rast se do te rezultojne 2 ose me shume oferta me pike te barabarta, perzgjedhja e fituesit do te behet me short, ne prani te ofertuesve.
- 12.5 Ndërprerja e procesit të përzgjedhjes së fituesit zbatohet vetëm në rast se, në përfundim të vlerësimit të ofertave dhe procesit të ankimimit, nuk rezulton asnjë ofertë e vlefshme.

13 . Administrimi i informacionit ne proces

- 13.1 Pas hapjes se ofertave, pa cenuar detyrimet e percaktuara ne kete dokument tenderi, informacionet per shqyrtimin, sqarimin, vleresimin e ofertave dhe rekomandimet per oferten fituese nuk u behen te njohura ofertuesve ose personave te tjere, qe nuk jane te angazhuar zyrtarisht ne kete proces, derisa te nenshkruhet autorizimi individual.
- 13.2 Pas hapjes se ofertave dhe deri ne shpalljen e ofertes fituese, asnje ofertues nuk ka te drejte te komunikojte me AKEP ose te perpiqet, ne çfaredolloj menyre, per te ndikuar ne

shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave, pervec rasteve te parashikuara dokumentin e tenderit.

14 . Njoftimi i fituesit dhe dhenia e autorizimit

- 14.1 AKEP, pas miratimit te raportit permblendes, sipas pikes 11.10 me siper, dhe me mbarimin e afateve te procedures ankimore, i dergon nje njoftim fituesit me shkrese zyrtare sipas Shtojca 17, si dhe publikon njoftimin ne faqen e tij te internetit sipas shtojca 17.
- 14.2 AKEP dhe ofertuesi fitues nenshkruajne autorizimin individual brenda 10 dite kalendarike. Kjo periudhe nuk do te tejkaloje afatin e vlefshmerise se ofertes, te percaktuar ne njoftimin e tenderit ose ne dokumentet e tenderit.
- 14.3 Autorizimi individual hyn ne fuqi kur nenshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga AKEP dhe pasi fituesi te kete kryer pagesat e parashikuara ne dokumentet e tenderit.
- 14.4 Kur ofertuesi fitues nuk arrin te nenshkruaje autorizimin individual, AKEP ben konfiskimin e sigurimit te ofertes dhe perzgjedh ofertuesin e radhes ne listen e ofertuesve qe kane mbetur. Njoftimi, sipas pikes 14.1 te ketij kreu, i dergohet ofertuesit, oferta e te cilit eshte perzgjedhur sipas kesaj pike.
- 14.5 Autorizimi individual i nenshkuar para perfundimit te afatit te njoftimit te fituesit apo para perfundimit te shqyrtimit administrativ, sipas ketij dokumenti tenderi, eshte absolutisht i pavlefshem.

15 . Kushtet per zbatimin e autorizimit individual

- 15.1 Autorizimi individual qe do te marre ofertuesi fitues do te permbaje detyrime per zbatim te kushteve te vecanta qe burojne nga fitimi i ketij tenderi dhe te perfshira ne kete dokument tenderi ne seksion 20 me poshte, ne perputhje me nenin 71, pika dh) te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008, i ndryshuar.
- 15.2 Kushtet qe rregullojne zbatimin e autorizimit individual, kane natyre jodiskriminuese dhe jane ne perputhje me objektin e tenderit.

16 . Procedura e ankimit

- 16.1 Çdo ofertues mund te kerkoje rishikim administrativ te procesit te tenderit, kur gjykon se nje vendim i AKEP eshte marre ne kundersizim me kete dokument tenderi ose me detyrimet qe rrjedhin prej zbatimit te VKM nr.1252, date 10.09.2008, i ndryshuar.
- 16.2 Ankesa paraqitet prane Keshillit Drejtues te AKEP brenda 5 diteve pune nga data kur ankimesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketyre rregullave.

- 16.3 Me marrjen e ankeses me shkrim, AKEP pezullon vazhdimin e procedures se tenderit, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit te afatit kohor, te percaktuar ne piken 16.4 me poshte.
- 16.4 Keshilli Drejtues i AKEP, shqyrton ankesen dhe merr nje vendim te arsyetuar brenda 5 dite kalendarike pas marrjes se ankeses, te cilin duhet t'ia njoftoje ankuesit jo me vone se ne ditën vijuese te punes.
- 16.5 Nese Keshilli Drejtues i AKEP nuk shqyrton ankesen brenda afatit kohor te percaktuar ne piken 16.4 me sipër, ose e rrezon atë, ankimesi mund te paraqese nje ankesë me shkrim prane Ministrin te Inovacionit dhe Administrates Publike, brenda 15 diteve kalendarike nga data e depozitimit te ankeses ne AKEP.
- 16.6 Ministri, me marrjen e ankimit, pezullon proceduren deri ne perfundimin e shqyrtimit te ankimit.
- 16.7 Ministri, brenda 20 diteve kalendarike pas marrjes se ankimit, duhet te beje shqyrtimin e ankimit.
- 16.8 Ne perfundim te shqyrtimit te ankimit, ministri kur e gjykon se nje vendim apo veprim i AKEP ka shkelur ndonje nga dispozitat e ketyre rregullave, ka te drejte te:
- a. anulaje plotesisht ose pjeserisht nje vendim apo veprim te AKEP te nxjerre ne kundërshtim me keto rregulla;
 - b. udhezaje AKEP te korrigoje shkeljet dhe me pas te vazhdoje me proceduren e tenderimit;
 - c. urdheroje anulimin e procedures per shpalljen e fituesit.

17 . Pagesat qe kryen fituesi

- 17.1 Çmimi i ofertes, i ofruar nga ofertuesi qe ka fituar te drejten e perdorimit te frekuences/brezit te frekuencave te tenderuar, derdhet prej tij ne Buxhetin e Shtetit ne perputhje me percaktimet e njoftimit te fituesit nga AKEP per kete qellim.
- Kjo pagese e cmimit te ofertes do te paguhet e plote dhe do te kryhet nga ofertuesi fitues brenda 7(shtate) diteve kalendarike nga marja e njoftimit te fituesit. Brenda ketij afati, ofertuesi fitues duhet te paraqesi prane AKEP dokumentin bankar qe verteton kryerjen e kesaj pagese. Nese fituesi deshton ne kryerjen e kesaj pagese brenda ketij afati, ai humbet te drejten per marrjen e Autorizimit Individual.
- 17.2 Ofertuesi fitues para marrjes se Autorizimit individual do te kryeje edhe pagesat e parashikuara ne kuadrin ligjor dhe rregullator per sipermarresit e rrjeteve dhe ofrimit te sherbimeve te komunikimeve elektronike, si me poshte:
- a. Pagese vjetore per perdorimin e frekuencave ne brezat 2520-2570/2620-2690 MHz dhe 2570-2620 MHz, te cilat do te llogariten sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.599 date 23.07.2010 “Per miratimin e pagesave qe kryhen ne Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare” , i ndryshuar me VKM Nr.25, datë 14.01.2014.

- b. Pagesen vjetore per tarifen e sherbimit per sherbimet e radiokomunikimit, per sistemet e levizshme tokesore, e cila llogaritet sipas Udhezimit nr.28 dt.20.10.2008 (Ky Udhezim gjendet ne faqen elektronike te AKEP ne adresen www.akep.al.
 - c. Pagesat vjetore te referuara ne piken "a" dhe "b", vleresohet te jene afersisht $720.000 + 3.210.000 = 3.930.000$ Leke per te drejte perdorimi 2x5 MHz per nje vit dhe $360.000 + 1.605.000 = 1.965.000$ Leke per te drejte perdorimi 5 MHz per nje vit. Te gjitha pagesat e tjera te mundshme, perfshire pagesen per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike, pagesen per caktimin dhe perdorimin e numrave e serive numerike si edhe pagesat per perdorim dhe tarifate per sherbimet e radiokomunikimit per frekuencat e mundshme te lidhjeve fikse radio per sistemet e transmetimit, do te paguhen pas marrjes se Autorizimit Individual dhe do te llogariten ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator respektiv.
- 17.3. Menyra dhe vlerat e pagesave te pikes 17.1 dhe 17.2.a dhe 17.2.b do t'i behet e njohur ofertuesit fitues nepermjet dergimit nga AKEP me shkrese zyrtare te dokumentit Njoftimi i Fituesit sipas formatit Shtojca 17 Formulari i Njoftimit te Fituesit

18 Gjeografia e perdorimit te frekuencave

Autorizimi Individual qe do t'i jepet fituesit, i jep atij te drejten qe te perdore frekuencat sipas percaktimit per cdo autorizim respektivisht ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise.

19 Kushtet per perdorimin e frekuencave

19.1 Fituesi/Operatori, ne mbeshtetje te Autorizimit Individual, eshte i detyruar te ndertoje rrjet tokesor te komunikimeve elektronike, si dhe te ofroje sherbime publike te komunikimeve elektronike, duke respektuar te gjitha kuadrin ligjor dhe rregullator te fushes.

19.2 Kushtet/kriteret per shfrytezimin dhe perdorimin e frekuencave jepen ne aneksin 1 dhe 2 te Autorizimit Individual shtojca 18.

20 Detyrimet e Fituesit qe burojne nga Tenderi.

- 20.1 Fituesi/Operatori eshte i detyruar te krijojte nje shoqeri tregtare sipas legjislacionit Shqiptar (ne se nuk e ka nje te tille) para marrjes se autorizimit individual, dhe te filloje shfrytezimin e ketyre frekuencave brenda nje periudhe prej 2 (dy) muajsh nga data e marrjes se Autorizimit Individual.

Autorizimi Individual eshte specifik per te autorizuarin. Ai nuk mund te shitet, jepet me qera, te transferohet apo te jepet si garanci pa miratimin paraprak te AKEP. Asnje ndryshim i kontrollit te te autorizuarit, qofte i drejteperdrejte apo i terthorte nuk mund te behet pa lejen paraprake me shkrim te AKEP.

- 20.2 Fituesi/Operatori me marrjen e Autorizimit Individual do te jete i detyruar qe te zbatoje:

- planin per shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit qe do ndertohet per mbulimin me sherbim, sipas deklarimit te dhene prej tij ne Shtojca 5;
 - ofrimin e te pakten sherbimeve te deklaruar sipas Shtojca 6;
 - standartet teknike te ITU dhe CEPT te deklaruar sipas Shtojca 7.
- 20.3 Zbatimi i detyrimeve te mesiperme 20.1 dhe 20.2, nuk duhet te kushtezohet nga fituesi apo parashikohet te kushtezohet nga ofertuesi, me te drejta te cilat mund ti lindin si pasoje e masave rregullatore ose detyrime per operatoret me FNT te mevonshme, por qe nuk jane ende ne fuqi ne kohen e njoftimit te tenderit, si p.sh roaming kombetar apo portabiliteti i numrit.
- 20.4 Fituesi/Operatori do te jete i detyruar qe brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes se Autorizimit Individual te paraqese prane AKEP nje projekt te detajuar per realizimin e Planit te deklaruar ne oferte dhe te ndertimit te rrjetit, menyren e realizimit te lidhjeve ndermjet stacioneve baze si dhe vendodhjen e tyre, me afate te percaktuara, te ndara per cdo vit te periudhes 3 vjecare. Operatori eshte i detyruar te raportoje prane AKEP lidhur me perqindjen e territorit qe mbulohet me sherbim prej rrjetit te ndertuar prej tij sipas grafikut te deklaruar ne Shtojcen 5.
- 20.5 Nese ofertuesi fitues/operatori nuk permbush te pakten nje prej detyrimeve te percaktuara ne Autorizimin Individual, AKEP ndermerr penalitete ne perputhje me nenin 135 dhe ne vijim te Ligjit 9918, date 19.05.2008, deri ne heqjen e autorizimit individual.

21 Dhenia e Autorizimit nga AKEP.

Dhenia e Autorizimit Individual do te behet brenda 10 diteve kalendarike pas shpalljes se fituesit dhe kryerjes te gjitha pagesave te referuara ne Seksionin 17 te Kreut II sipas percaktimeve te dokumentit te tenderit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. 9918, date 19.5.2008, i ndryshuar. Autorizimi Individual qe do i jepet ofertuesit fitues do te plotesohet nga AKEP dhe ofertuesi fitues sipas Formulari i Shtojca 19.

22 Vlefshmeria e Autorizimit Individual

Autorizimi Individual do te jete i vlefshem per nje periudhe 15 (pesembedhjete) vjet, me mundesi rinovimi ne fund te perfundimit te periudhes se vlefshmerise. Rinovimi do te behet ne perputhje me percaktimet e Ligjit nr. 9918, date 19.5.2008, i ndryshuar, apo legjislacionit ne fuqi ne kohen perkatese.

23 Interkoneksioni

Fituesi/Operatori ka te drejten dhe obligimin te negocioje me operatoret e tjere lidhur me interkoneksionin, ne perputhje me percaktimet perkatese te Ligjit nr. 9918, date 19.5.2008, i ndryshuar. Per me shume informacion shiko informacionin e dhene ne Kreu III, Informacion i pergjithshem.

24 Autorizimi i pergjithshem

Pas kryerjes se pageses se cmimit te ofertes , ofertuesit fitues do te rregjistrohen prane AKEP si ofrues te rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike ne perputhje me rregullat per Autorizimin e pergjithshem, ne se nuk e kane nje te tille ose ka nevojte per

modifikim. Informacion me te detajuar ne lidhje me njoftimin dhe rregullat per Autorizimin e pergjithshem do te gjeni ne adrsen www.akep.al

25 Autorizimi Individual

Fituesi i marrjes se te drejtes se perdorimit te frekuencave, do ti jepet Autorizim Individual, sipas formatit te dhene ne shtojcen 18. Autorizimi individual do te perfshije dhe detyrimet qe rrjedhin nga fitimi i tenderit, te percaktuara ne seksionin 20 me siper.

26 Grafiku i zhvillimit te Tenderit

Procedura per zhvillimin e tenderit dhe dhenien e Autorizimit Individual do te zhvillohet ne perputhje me grafikun e meposthem (Datat jane referuese dhe mund te ndryshojne per arsye te percaktuara ne kete dokument tenderi):

Nr	Veprimi	Data/Afati
1	Njoftimi per hapjen e procedures se tenderit	20.02.2015
2	Dergimi i kerkesave per sqarime ose i pyetjeve nga te interesuarit	Deri me 02.04.2015
3	Kthimi i pergjigjeve nga AKEP	Brenda 3 diteve kalendarike nga Depozitimi i kerkeses ne piken 2
4	Dorezimi (paraqitja) e ofertave	Deri me 09.04.2015 Ora 10.00 AM
5	Hapja e Ofertave	09.04.2015 Ora 10.00 AM
6	Vleresimi, klasifikimi i ofertave dhe njoftimi nga KVO	Deri me 23.04.2015
7	Ankesa nga ofertuesit per njoftimin e klasifikimit te AKEP, drejtuar AKEP	Brenda 5 (pese) dite pune nga data e Njoftimit ne piken 6
8	Pergjigje e AKEP per ankesat e pikes 7	Brenda 5 (pese) dite pune nga data e ankeses ne piken 7
8	Paraqitja e Raportit Permbledhes te KVO prane AKEP	Deri me xx.xx.2015
9	Ankesa nga ofertuesit per njoftimin e klasifikimit te AKEP, drejtuar Ministrit per Inovacionin dhe Administratën Publike	Brenda 15 dite kalendarike nga data e depozitimit te ankeses ne AKEP ne piken 7
11	Pergjigje e Ministrit per Inovacionin dhe Administratën Publike per ankesat e pikes 9	Brenda 20 dite kalendarike nga data e marrjes se ankeses ne piken 9
12	Shpallja e Fituesve nga AKEP	Deri me

13	Pagesa per cmimin e ofertes nga Fituesit	Brenda 7 diteve kalendrike nga data e marrjes se njoftimit te fituesit
14	Pagesa per frekuencat e alokuara	Brenda 10 diteve kalendrike nga data e marrjes se njoftimit te fituesit
15	Dhenie e Autorizimit Individual	Brenda 10 diteve kalendrike nga data e marrjes se njoftimit te fituesit

27. VEPRIMET E JASHTËLIGJSHME

1. Në përputhje me legjislacion për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, AKEP e refuzon një ofertë, nëse ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të AKEP një dhuratë në kesh ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së prokurimit publik; dhe/ose
- është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga AKEP të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me prokurimin, apo ka lidhje me anëtarë të komisionit të vlerësimit etj.
- Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentin e Tenderit

2. AKEP e informon me shkrim Ofertuesin dhe për refuzimin e kërkesës ose ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e prokurimit.

28. ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

AKEP dhe Ofertuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

KREU III - INFORMACION I PERGJITHSHEM

3.1 KUADRI LIGJOR

- *Legjislacioni*

Sektori i komunikimeve elektronike ne Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim që, nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike, të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj është në përputhje me paketën Rregullatore të BE-së në fushën e komunikimeve elektronike sipas direktivave 2002;

- Direktiva 2002/19/EC për “Aksesin dhe interkonjeksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese”, amenduar.
- Direktiva 2002/20/EC për “Autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” (Direktiva e Autorizimit).
- Direktiva 2002/21/EC për “Kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” (Direktiva Kuadër), amenduar.
- Direktiva 2002/22/EC për “Shërbimin Universal dhe te drejtat e përdoruesve ne lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” (Direktiva e Shërbimit Universal).
- Direktiva 2002/58 për “Privatësinë dhe komunikimet elektronike”, amenduar.
- Direktiva 2002/77/EC për “Konkurrencën ne tregjet për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike”.

- *Dokumenta rregullatore kryesore*

- Rregullore per njoftimin e autorizimit te pergjithshem
- Rregullore per autorizim individual
- Rregullore per aksesin dhe interkoneksionin
- Rregullore per analizen e tregut
- Rregullore per portabilitetin e numrit
- Rregullore për administrimin e NSP/ISPC
- Rregullore e konformitetit
- Rregullore per treguesit e cilesise se sherbimit
- Rregullore per licensat “**ald**” dhe kodin “**aaic**”
- Rregullore per radioamatorizmin
- Rregullore per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike
- Rregullore per kushtet e perdorimit te frekuencave dhe kerkesat per pajisjet radio qe perdoren pa autorizim individual
- Rregullore e administrimit te emrave te domain-eve nen.al
- Rregullore per dhenien e licenses per stacionet radio te avionit
- Rregullore per dhenien e licenses per stacionet radio te anijes
- Rregullore per dhenien e certifikates operatorit radiodetar
- Rregullore per dhenien e autorizimit per stacionet radio bregdetare
- Rregullore per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipermarysve te rrjeteve dhe ose sherbime te komunikimeve elektronike etj.

3.2 AUTORIZIMI PËR TË OFRUAR RRJETE DHE SHËRBIME TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM:

Sipas ligjit 9918/2008, i ndryshuar, autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- a) Përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuar;
- b) Pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

Gjithashtu ligji 9918/2008, i ndryshuar, përcakton kompetencën e AKEP-it për regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit. Gjithashtu me ndryshimet e pësuar ky ligj me ligjin 102/2012, AKEP-i disponon kompetencën e përcaktimit të rregullave për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare, si dhe rregullave dhe kërkesave teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore.

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike bazohet në dispozitat e rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, e ndryshuar, shoqëruar kjo me aplikacionin përkatës *on-line*.

Sipërmarresit që kanë përfunduar me sukses aplikimin pajisen me Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit.

Me poshtë paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike sipërmarrësit dhe autorizime /licenca/ certifikata të regjistruara në AKEP deri në fund të vitit 2013.

Tabela 1: Sipërmarrësit e regjistruar në AKEP gjithsej deri në fund të vitit 2013:

Nr.	Sipërmarrës	Aplikime të konfirmuara		Të regjistruar		Të çregjistruar	
		2012	2013	2012	2013	2012	2013
1	Sipërmarrës të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike	160	253	157	240	3	13

Shënim: Nga (240) sipërmarrës të regjistruar, (74) janë të regjistruar për rrjet TV Kabllor. Shifrat për vitin 2013 përfshijnë dhe shifrat për vitin 2012.

Të dhënat e tabelës 1 për sipërmarrësit e regjistruar në vitet 2012 dhe 2013, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:




Tabela e Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftuara dhe regjistruara në AKEP nga sipërmarrësit gjithsej në periudhën 02.02.2012 deri 31.12.2013 dhe në vitin 2013:

Nr.	Shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara nga sipërmarrësit	Sipërmarrës të regjistruar që kanë njoftuar shërbimet	
		Gjithsej nga 02.02.2012 deri 31.12.2013	Viti 2013
1	Telefoni e lëvizshme	4	-
2	Telefoni fikse	79	7
3	Telefoni me anë të kartave të parapaguara.	7	3
4	Internet	131	19
5	Transmetim të dhëna	58	6
6	Shërbim me vlerë të shtuar	31	5
7	Linja me qera	17	2

3.3 PANORAMA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Gjatë vitit 2013 sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rritje të përdorimit të shërbimeve të rrjeteve celulare (telefoni dhe internet 3G) dhe shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete fikse, ndërsa ka pasur ulje të përdorimit të telefonisë fikse. Këto tendenca janë të ngjashme me tendencat e viteve të fundit, ku përdorimi i telefonisë fikse ka qënë në rënie duke u zëvendësuar me telefoninë celulare, dhe aksesit broadband ka pasur rritje në të dy segmentet: nga rrjete fikse dhe rrjete celulare.

Shërbimet e ofrura nga rrjetet celulare patën rritje në 2013, ku rritje të ndjeshme kishin shërbimet 3G. Numri i përdoruesve aktiv të telefonisë celulare (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milion në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, pati reduktim me 6%, duke

arritur në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM. Numri i pajtimtarëve celularë që përdorin shërbimet 3G të aksesit broadband në 2013 arriti në rreth 1.2 milion, duke u rritur me 90%: numri pajtimtarëve me akses broadband 3G me karta USB/modem u rrit me 101 % ndërsa numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G nga aparatet celulare u rrit me 88%

Në shërbimet e ofrura nga rrjetet fikse, aksesit broadband në Internet kishte rritje të ndjeshme (me 14%), ndërsa numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Rënia e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse ka ardhur kryesisht për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelcom si dhe nga ndryshimi në të dhënat e raportuara nga operatori më i madh alternativ Abcom, i cili ka raportuar një reduktim me rreth 20 mijë pajtimtarë. Ky reduktim nga Abcom vjen për shkak të mënyrës së matjes prej tij të numrit të pajtimtarëve telefonikë, duke raportuar vetëm ata pajtimtarë që përdorin dhe paguajnë për shërbim telefonik. Sic është theksuar edhe në raportin vjetor 2012, evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore ne drejtim të kërkesës për akses në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për zhvillimin e rrjeteve fikse të jete aksesit broadband në Internet. Numri pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në 2013 u rrit me 14% në krahasim me 2012, dhe vihet re se të gjithë operatorët kryesorë kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Norma e penetrimit me të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje. Dy figurat e mëposhtëme paraqesin ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare (përdorues aktivë) dhe telefonisë fikse në raport me aksesin broadband me rrjete celulare dhe rrjete fikse. Figurat tregojnë qartë se normat e rritjes së aksesit broadband në të dy llojet e rrjeteve janë më të larta se të telefonisë.

Figura1: Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë celulare dhe aksesit broadband 3G





Figura 2: Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse dhe aksesit broadband fiks



Në figurën e mësipërme duhet të kemi parasysh se rrjetet fikse kanë pasur zgjerim në dy pjesët kryesore, rrjet bazë (core) dhe akses, dhe se tendenca është drejt rrjeteve IP dhe shërbimeve që mundësojnë këto rrjete (si akses broadband) por që përfshijnë dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve telefonike, nëpërmjet platformave të ndryshme VoIP, të cilat kanë filluar të kenë përdorim të lartë jo vetëm në rrjete fikse por edhe në rrjete celulare.

3.4 TREGUES FINANCIARË TË SEKTORIT¹

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2012 ishin rreth 55377 milion lekë të cilat përbëjnë një rritje prej rreth 6.65 % në krahasim me vitin 2011 kur të ardhurat ishin 51922 milion lekë. Rritja e të ardhurave të sektorit ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave të operatorëve celularë.

Peshën kryesore të këtyre të ardhurave e zënë ato që vijnë nga rrjetet celulare, të cilat për vitin 2012 ishin 42.01 miliard lekë, kundrejt 39.2 miliard lekë që ishin në vitin 2011, pra një rritje me rreth 7.2 %. Edhe të ardhurat që vijnë nga rrjete fikse (Albtelecom + OA) për vitin 2012 kanë pasur rritje me rreth 4.7%, krahasuar me 2011, nga 12.8 miliard lekë në rreth 13.4 miliardë lekë. Brenda vetë sektorit të rrjeteve fikse vihet re një rritje prej rreth 12 % në të ardhurat e Albtelecom, krahasuar me 2011, por ka një rënie prej rreth 15 % në të ardhurat e OA. Sipërmarrësit alternativë më të mëdhenj sipas të ardhurave janë Abcom, ASC, Primo, Abissnet, Nisatel, IT-Tirana, ATU, të cilët së bashku zënë rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo mbi 80% të peshës totale të të ardhurave të operatorëve alternativë.

¹ Përditësimi për të ardhurat dhe tregues të tjerë financiarë në këtë raport është për vitin 2012, pasi të dhënat financiare të operatorëve depozitohen në AKEP brenda datë s 10 Prill të vitit pasardhës.

FIGURA 3: TË ARDHURAT TOTALE TË OPERATORËVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2012)





FIGURA 4: ECURIA E TË ARDHURAVE TOTALE TË OPERATORËVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2008-2012)



3.5 TELEFONIA CELULARE

Tabela e mëposhtëme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2012 dhe 2013 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

Tabela 1: Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2012-2013

	Njesia	2012	2013	Ndryshimi %
Numri i përdoruesve aktive	numër	3,537,285	3,685,983	4%
Numri i përdoruesve sipas kartave SIM aktive	numër	5,619,607	5,282,350	-6%
Numri i pajtimtarëve që përdorin akses në internet me GPRS/EDGE	numër	1,380,584	713,559	-48%
Numri pajtimtarëve me akses në Internet broadband UMTS në total:	numër	649,713	1,231,259	90%
nëpërmjet aparatit të telefonit celular	numër	594,308	1,119,892	88%
nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	numër	55,405	111,367	101%
Thirrje telefonike (dalëse)të gjeneruara nga përdoruesit	minuta	6,053,089,264	6,769,300,966	12%
Numri i mesazheve SMS të gjeneruara	numër	1,382,610,330	1,689,200,882	22%
Volumi total i të dhënave të transmetuara me GPRS/UMTS	Mbyte	815,104,421	2,590,258,474	218%
Thirrje hyrëse nga rrjete të tjera (Terminim thirrjesh)	minuta	1,046,035,623	990,247,214	-5%
thirrje hyrëse kombëtare	minuta	290,628,294	335,122,643	15%
thirrje hyrëse ndërkombëtare	minuta	755,407,329	655,124,571	-13%
SMS hyrëse nga rrjete të tjera (terminim SMS)	numër	75,084,782	75,386,098	0%

Nga të dhënat e tabelës vihet re se të gjithë treguesit janë më rritje, përveç treguesve të numrit të përdoruesve, pajtimtarët që përdorin GPRS/EDGE dhe terminimit të thirrjeve hyrëse nga rrjete ndërkombëtare. Treguesit me rritje më të madhe janë numri i pajtimtarëve me akses në Internet broadband UMTS (që shpjegon rënien e numrit të përdoruesve me akses GPRS/EDGE), volumi i të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare (që shpjegohet nga rritja e përdorimit të shërbimeve 3G).

Numri i përdoruesve celularë

Numri i përdoruesve celularë matet dhe raportohet në dy mënyra:

- Numri i përdoruesve sipas kartave ‘SIM aktive’ që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive² në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit;
- Numri i ‘përdoruesve aktivë’ që janë përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit


AKEP në publikimet e viteve të fundit ka raportuar numrin e përdoruesve celularë sipas dy mënyrave. Praktikata e raportimit të numrit të përdoruesve celularë ndryshojnë në vende të ndryshme, por kohët e fundit ka një rritje të raportimit të numrit të përdoruesve celularë aktivë. Në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të përdoruesve celularë

² Secili operator ka politikata e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejë komunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

sipas “përdoruesve aktiv”, por ndërkohë në disa raste jepen edhe tregues bazuar në numrin e përdoruesve celularë sipas kartave ‘SIM aktive’. Ky përbën ndryshim nga raportet e mëparshme ku si bazë është përdorur numri i përdoruesve celularë sipas ‘kartave SIM aktive’, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh këtë ndryshim. Të dhënat për numrin e përdoruesve celularë sipas kartave SIM aktive janë të disponueshme që prej vitit 1996, ndërsa sipas treguesit ‘përdorues aktivë’ që prej vitit 2010.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milionë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që norma e rritjes ndryshon sipas operatorëve: Plus dhe Vodafone kanë rritje me 9 dhe 11% respektivisht, ndërsa Altelecom (EM) dhe AMC kanë reduktim 2 dhe 3% respektivisht. Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2013.

FIGURA 2: ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË AKTIV 2010-2013



Në fund të vitit 2013, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 6%, dhe ai varion sipas operatorëve: AMC dhe Vodafone kanë rritje me 10 dhe 11%, Plus ka rritje të vogël me 2%, ndërsa Altelecom (Eagle Mobile) ka rënie të ndjeshme me 52%. Rënia e madhe e numrit të përdoruesve celularë të EM përbën edhe arsyen e rënies për herë të parë të këtij treguesi, që prej fillimit të shërbimeve celulare në Shqipëri në 1996. Reduktimi i madh i këtij treguesi për EM vjen për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të numrit të kartave SIM aktive nga Eagle Mobile³.

Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM në periudhën 2000-2013, Figura 3, paraqet numrin e përdoruesve celularë sipas dy treguesve: ‘përdorues aktivë’ dhe ‘karta SIM aktive’. Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 70%

³ EM deri në fund të vitit 2012 ka raportuar për këtë tregues vlerën kumulative të kartave SIM të shitura që prej fillimit të aktivitetit të tij deri në fund të periudhës përkatëse, ndërsa duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, EM ka rivlerësuar numrin e pajtimtarëve duke i u referuar vetëm kartave SIM aktive në fund të periudhës përkatëse.

për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 63% për EM në 74% për Vodafone. Ndryshimin më të madh të këtij proporcioni e ka EM, nga 31% në fund të 2012 në 63% në fund të 2013 (shiko shënimin për arsyen e këtij ndryshimi të madh), raport që është i ngjashëm me atë të tre operatorëve të tjerë.

FIGURA 3. ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KARTAVE DHE SIM 2000-2013





FIGURA 4: ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË “AKTIVE” DHE SIM 2010-2013




Ndërkohë midis operatorëve ka diferenca të mëdha për sa i përket strukturës së përdoruesve: në përdorues me parapagim dhe me kontratë. Tabela e mëposhtme paraqet peshën që zënë përdoruesit me kontratë në numrin total të përdoruesve, aktivë dhe sipas kartave SIM. Sikurse mund të vihet re përdoruesit me kontratë përbëjnë 13% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë dhe 9 % të numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive.

